



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2910/2 prot.

Datë 23.11.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-75800-07-24-2023, me objekt: “Blerje Materiale Kancelarie Ndarë Në 3 Lote”, (marrëveshje kuadër), me fond limit 20,459,753 lekë (pa tvsh), Loti 2, me objekt “Materiale kancelarie të tjera zyre”, me Nr. REF-75817-07-24-2023, me fond limit 3,716,833 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 09.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Infsoft Office” SHPK me NIPT J6246002Q dhe adresë: Kashar, Autostrada Tiranë Durrës, Km 8, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** “Librari Dyrrahu” SHPK me NIPT L91418502J dhe adresë: Zona Kadestrale nr.8517, e llojit trull plus ndertese 4 kate, me siperfaqe truall 1’000 m2 dhe siperfaqe ndert, Durrës.

Në datën 22.11.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe njëherazi pranë autoritetit kontraktor është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3636, si dhe nr. protokollit 2910, datë 22.11.2023 i operatorit ekonomik “Infsoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-75800-07-24-2023, me objekt: “Blerje Materiale Kancelarie Ndarë Në 3 Lote”, (marrëveshje kuadër), me fond limit 20,459,753 lekë (pa tvsh), Loti 2, me objekt

“Materiale kancelarie të tjera zyre”, me Nr. REF-75817-07-24-2023, me fond limit 3,716,833 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 09.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK në procedurën e prokurimit

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/ skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime**”.

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat, operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, të kriterëve si më poshtë:

1.KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

Gjithashtu në ankesë ngrihen pretendime se, oferta e operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, është ofertë anomalisht e ulët bazuar në nenin 93 të LPP.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 23.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri